

KRITERET E TENDERËVE NDIKIMI NË KONKURRENCË



RAPORTI I MONITORIMIT TË PROKURIMIT PUBLIK NË SHSKUK

COPYRIGHT © 2019. Kosova Democratic Institute (KDI).

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohen në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jokomerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi, është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren. Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 38,
10000, Prishtinë, Kosovë.
Tel.: +381 (0)38 248 038
E-mail: info@kdi-kosova.org
Web: www.kdi-kosova.org

PËRMBAJTJA

6 LISTA E SHKURTESAVE

7 PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

8 KATËR PROBLEMET ME DOSJET E TENDERIT

8 Kërkesa për Autorizim Marketing

9 Aplikimi i kriterëve jo standarde

10 Blerja e produkteve me specifika tjera nga ato të përcaktuara me Listën e Barnave Esenciale

12 Blerje duke tejkaluar vlerën e parashikuar

14 KONKLUSIONE

15 REKOMANDIME

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (SHSKUK) i themeluar me Ligjin për Shëndetësi nga Qeveria e Kosovës, është institucion shëndetësor që përbëhet nga institucionet e nivelit dytësor dhe tretësor të kujdesit shëndetësor në sektorin publik të shëndetësisë.

Në të kaluarën furnizimi me barna për nivelin dytësor dhe tretësor¹ për SHSKUK është bërë nga Ministria e Shëndetësisë përmes procedurave të prokurimit. Prej marsit të vitit 2019, me vendim të MSH, këto kompetenca, përfshirë edhe buxhetin, i janë bartur SHSKUK-së. Furnizimi me produkte dhe pajisje medicinale për nivelin parësor² vazhdon të jetë përgjegjësi e MSH-së.

KDI, përmes këtij punimi, ka analizuar menaxhimin e procesit të prokurimit nga ana e SHSKUK gjatë kësaj periudhe "tranzitore", më saktësisht përpilimin e Dosjeve të Tenderit (DT) për furnizim me produkte dhe pajisje medicinale nga Lista e Barnave Esenciale (LBE). Analizimi i 12 mostrave të dosjeve të tenderit gjatë periudhës mars-qershor 2019, ka shpërfaqur disa probleme, të elaboruara në vazhdim.

Përfshirja e kërkesës për **Autorizimin për Marketing** në Dosjen e Tenderit është duke kufizuar ofertimin në tenderët për furnizim me produkte medicinale për faktin se operatorët ekonomik (OE) po hezitojnë të paguajnë 2000 euro për Certifikatë të Autorizimit për Marketing pa u siguruar se do të shpërblehen me kontratë.

Mungesa e standardizimit të kriterëve (kërkesave) në dosjet e tenderit është evident. Kjo nënkupton që në disa dosje të tenderit aplikohet një kriter, e në të tjerat jo, siç është rasti i kërkesës "mbi mundësitë teknike dhe profesionale" që aplikohet vetëm në tenderët për furnizim me pajisje medicinale (materiale shpenzues) por jo edhe në tenderët për furnizime me produkte medicinale (barna dhe citostatik). Duke mos aplikuar kritere standarde, Autoriteti Kontraktues mund të favorizojë apo diskriminojë kompanitë në një proces tenderimi.

SHSKUK vazhdon të blejë produkte dhe pajisje medicinale **që nuk i përshtaten specifikave të përcaktuara me Listën e Barnave Esenciale**. Në katër dosje të tenderit, edhe pse janë vendosur specifikat e produkteve sipas LEB, SHSKUK u ka lejuar operatorëve ekonomikë të ofertojnë me produkte, specifikat e të cilave nuk janë përshtatur me ato në dosje të tenderit.

Vlera e parashikuar është tejkaluar për 10 Lot-e të përfshira në gjashtë dosje të tenderit. Kjo dukuri e shpeshtë tregon për probleme në fazën e planifikimit të tenderimit. Vlera e parashikuar e tenderit është shumë e rëndësishme të përcaktohet sa më saktë që është e mundur duke iu referuar një hulumtimi të tregut paraprak si dhe çmimeve në rajon.

¹ QKUK, QKUSK, Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike (IKSHP), Qendrat kombëtare të lëmive të ndryshme të mjekësisë, Spitalet e përgjithshme, Qendrat e shëndetit mendor dhe Qendra për integrim dhe rehabilitim të sëmurëve kronik psikiatrik në Shtime.

² Qendrat kryesore të mjekësisë familjare (QKMF) me njësitë përberëse të tyre.

KDI ka analizuar dymbëdhjetë (12) dosje të tenderëve për furnizim me produkte dhe pajisje medicinale në SHSKUK brenda periudhës mars – qershor 2019. Deri më tani për këta 12 tenderë janë publikuar dhjetë njoftime për kontratë (122 Lot-e) dhe një njoftim për nënshkrim të kontratës (dy Lot-e). Të gjeturat nga analizi i Dosjeve të Tenderit mund të flasin për katër çështjet në vijim:

Autorizim Marketingu është çertifikatë nga AKPPM për aprovimin e produkteve medicinale për treg në Kosovë, bazuar në plotësimin e kërkesave për kualitet, siguri dhe efikasitet për përdorim human në tretmanin terapeutik³.

Lidhur me këtë çështje, përfaqësues nga Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale, kanë rekomanduar që në dosje të tenderit të mos kërkohet ekskluzivisht Autorizimi i Marketingut nga AKPPM. Për më tepër, ata sygjerojnë që operatorëve ekonomikë t'u mundësohet ofertimi edhe me produkte të autorizuara për tregëtim nga shtetet për të cilat ekzistojnë procedurat për njohje të njëanëshme të autorizimit për marketing për produktet medicinale të aprovuara nga agjencionet rregullative në Gjermani dhe Britani të Madhe, me kusht që ato të pajisen me AM pasi të shpallen fitues dhe para nënshkrimit të kontratës.

AKPPM ka prezantuar se si në një rast të caktuar është përdorur kjo metodë dhe AKPPM me procedurë të përsheptuar pas njoftimit nga Autoriteti Kontraktues ka pajisur me certifikatë operatorin brenda dy javëve. Pra, nuk ekziston asnjë kufizim ligjor që ndalon Autoritetet Kontraktuese që në dosje të tenderit të mundësojnë ofertimin edhe të operatorëve që posedojnë autorizim marketingu nga vendet e BE-së⁶.

6 Fokus grup i mbajtur nga KDI me zyrtar të AKPPM, MSH dhe Operator Ekonomik, më 12.07.2019

KDI ka analizuar politikat dhe praktikat e Shqipërisë lidhur me furnizimin me barna të paautorizuara për tregëtim në Republikën e Shqipërisë, dhe ka gjetur se për ta futur në treg publik, bari që ofertohet duhet të plotësoj së paku njërin prej kriterëve në vijim:

- të ketë marrë autorizim për tregëtim dhe të qarkullojë në njërin nga vendet e Bashkimit Evropian, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Kanada, Turqi, Zvicër, Izrael, Japoni, Australi;
- të jetë i prodhuar në vendet e Ballkanit, vetëm nëse ka marrë autorizim për tregëtim dhe qarkullon në vendin e tij,
- të jetë i pajisur me autorizim për tregëtim nga Agjencia Evropiane e Barnave (EMA), ose Institucioni i Administrimit për Ushqimin dhe Barnat (FDA) i Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

SHSKUK dhe Ministria e Shëndetësisë mund të përdorin këtë shembull dhe nuk ka asnjë përkufizim ligjor që ndalon përdorimin e kësaj praktike.

Aplikimi i kriterëve jo standarde

Gjatë vlerësimit të 12 dosjeve të tenderit në SHSKUK, KDI ka vërejtur se kriteret e përzgjedhjes së operatorëve ekonomik nuk vendosen sipas një standardi të njejtë mirëpo ndryshojnë edhe pse bëhet fjalë për furnizime të ngjashme. Mungesa e kriterëve standarde i jep hapësirë Autoritetit Kontraktues që në raste të caktuara të favorizojë apo diskriminojë operatorë ekonomikë të caktuar.

Për t'a ilustruar aplikueshmërinë e kriterëve jo standarde në dosje të tenderit marrim shembull **"kërkesën mbi gjendjen ekonomike dhe financiare"** e cila duhet të përmbushet nga operatorët ekonomik në mënyrë që ata të ofertojnë në tender. Kjo kërkesë parashihet edhe më Ligjin për Prokurim Publik dhe me rregullat e prokurimit dhe ka për qëllim të vlerësojë nëse tenderuesi ka stabilitet të mjaftueshëm financiar dhe ekonomik për të realizuar kontratën⁷.

KDI ka vërejtur që kjo kërkesë nuk është përfshirë në asnjë dosje të tenderit në SHSKUK për furnizime me produkte dhe pajisje medicinale nga LBE edhe pse bëhet fjalë për tendera milionësh.

Kriter tjetër jo standard është edhe kriteri për "Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale". Nga 12 mostra të dosjes së tenderit ky kriter është paraparë vetëm në pesë dosje. Ky është kriter minimal i kualifikimit i paraparë me Ligjin për Prokurim Publik dhe Rregulloren e Prokurimit Publik që shrytëzohet nga Autoriteti Kontraktues për të siguruar se ofertuesit kanë aftësi teknike për realizimin e kontratës, zakonisht përmes kërkesës për një listë të kontratave të përmbushura të natyrës së ngjashme. Një kërkesë e tillë, është pjesë e dosjeve të tenderit për aktivitetet e prokurimit që kanë të bëjnë vetëm me furnizimet me material medicinal nga LBE, por një kërkesë e tillë nuk është përfshirë në dosjet e tenderit për furnizime me barna dhe citostatikë.

⁷ Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik neni 26: Shënim për kërkesat e gjendjes ekonomike dhe financiare (neni 68 i LPP-se).

|||||

Nga ajo që shihet nga analizimi i Dosjeve të Tenderit⁸, kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale janë duke u aplikuar vetëm në tenderët për furnizime me material medicinal dhe jo edhe në furnizimet me produkte medicinale. Në pyetjen e KDI-së lidhur me këtë kriter, zyrtarë të prokurimit në SHSKUK⁹ janë përgjigjur se ky kriter është i nevojshëm për shkak se operatorët ekonomikë të cilët ofertojnë në një proces të prokurimit publik duhet të dëshmojnë përvojë në furnizim dhe të sigurojnë cilësi në produkte. SHSKUK, në të ardhmen planifikon të përdor këtë kriter në të gjitha dosjet e tenderit.

Duke marrë parasysh se sektori i shëndetësisë është sektor i ndjeshëm dhe kualiteti i ofrimit të furnizimeve është shumë i rëndësishëm edhe kriteret në dosjet e tenderët për furnizime me produkte dhe materiale medicinale duhet të vendosen në atë mënyrë që Autoriteti Kontraktues të fitojë siguri të mjaftueshme që operatorët ekonomikë të kanë kapacitete ekonomike dhe teknike për realizimin e kontratave.

Blerja e produkteve me specifika tjera nga ato të përcaktuara me Listën Esenciale të Barnave

Kur kërkohet furnizim me produkte nga Lista e Barnave Esenciale, specifikat teknike në dosjen e tenderit duhet të jenë të njëjta me ato të specifikuar në këtë listë, por KDI ka vërejtur që këto specifika teknike shpeshherë nuk janë respektuar. Në katër dosje të tenderit autoriteti kontraktues u ka lejuar OE-ve të ofertojnë me produkte, specifikat e të cilave nuk kanë qenë konform specifikave të DT, rrjedhimisht specifikave të produkteve në Listën e Barnave Esenciale.

Kur operatorët ekonomikë kanë pyetur¹⁰ Autoritetin Kontraktues (SHSKUK-në) nëse mund të ofertojnë me produkte të cilat kanë specifika të ndryshme nga ato të kërkuara në dosje të tenderit, SHSKUK nga 12 dosje të tenderit në katër dosje ka dhënë përgjigje të ndryshme, në disa raste ka lejuar, duke u thirrur në atë që edhe MSH-së në të kaluarën ka pranuar të njëjtat specifika, ndërsa në rastet tjera nuk ka lejuar specifika jashtë atyre të përcaktuara në Listën e Barnave Esenciale¹¹.

Një veprim i tillë është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Prokurorim Publik, ku përcaktohet qartë se vetëm operatorët që ofertojnë me produkte sipas kërkesave dhe specifikimeve të përcaktuara në Dosje të Tenderit konsiderohen të përgjegjshëm¹².

Ky problem edhe mund t'i atribuohet vonësës së revidimit të Listës së Barnave Esenciale, kur dihet që lista aktuale ka mangësi të shumta dhe specifikimet teknike të produkteve nuk janë të përcaktuara në mënyrë që i përshtaten nevojave të klinikave apo i përshtaten ofertës në treg.

Tabela në vijim ilustron rastin për dosjen e tenderit për furnizim me material medicinal nga Lista e Barnave Esenciale,¹³ kur për një produkt të njëjtë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit, operatorët ekonomikë kanë bërë pyetje pranë Autoritetit Kontraktues dhe kanë marrë përgjigje të ndryshme.

8 Dosjet e Tenderit për furnizim me Barna, Material medicinal dhe Citostatik me nr. të prokurimit: 00220-19-905-111, 00220-19-908-111, 00220-19-1250-111, 00220-19-2031-111, 00220-19-2198-111, 00220-19-2516-111, 00220-19-2675-111, 00220-2831-111, 00220-3566-111, 00220-19-2142-111, 00220-19-2446-111, 00220-19-3566-111

9 Takim me zyrtar të prokurimit në SHSKUK më 07.05.2019.

10 Sipas LPP Neni 53, OE-të kanë të drejtë për të parashtruar tek AK pyetje sqaruese rreth DT.

11 Pyetjet dhe përgjigjet për Dosje të Tenderit:

file:///C:/Users/Asus/AppData/Local/Temp/Temp3_DosjaTenderit.zip/Pyetjet%20Sqaruese.PDF

file:///C:/Users/Asus/OneDrive%20-%20Transparency%20International/Desktop/DOSJET%20SHSKUK/00220-19-2037-1-1-1/Pyetjet%20dhe%20Pergjigje%20ne%20kerkesat%20per%20sqarimn%20e%20tenderit%202037.pdf

file:///C:/Users/Asus/OneDrive%20-%20Transparency%20International/Desktop/DOSJET%20SHSKUK/00220-3566-1-1-1/Pergjigjja%20ne%20pytjen%20sqaruse%20te%20tenderit.PDF

12 Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik neni 41.5 pika b.: Tenderi konsiderohet të jetë i përgjegjshëm kur: është në pajtueshmëri në termet teknike me përshkrimin, kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në dosje të tenderit;

13 E-Prokurimi, NJOftim për Kontratë i dates 31.05.2019

https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=392513

|||||

Tabela 1: Kërkesa nga Autoriteti Kontraktues për produktin dhe specifikat e produktit në Lot 11, të përfshirë në dosjen e tenderit për furnizim me material medicinal nga Lista Esenciale

Furnizim me material medicinal nga LE		
LOT 11	I.V. PLACEMENT UNIT	SPECIFIKAT E PRODUKTIT
11.1	I.V. PLACEMENT UNIT, SHORT , LUER TYPE DISPOSABLE	16 G, 2.1 x 55 mm
11.2	I.V. PLACEMENT UNIT, SHORT , LUER TYPE DISPOSABLE	20 G, 1.1 x 32 mm
11.3	I.V. PLACEMENT UNIT, SHORT , LUER TYPE DISPOSABLE	22 G, 0.8 x 25 mm

Pyetjet nga OE		Përgjigje nga AK
1	Lot 11.1: A lejohet ofertimi me këtë specifikacion: 16G 2.0 x 45 mm ?	Meqenëse është lejuar më parë edhe nga MSH-se dhe nuk ka vërejtje nga Klinikat mund të ofroni me dim. 2.0 x 45mm nëse nuk oferton ndonjë OE tjetër sipas L. Esenciale
2	Lot 11.2 : A lejohet Ofertimi me me kete specifikacion: 16 G,1.6x 45 mm ?	Meqenëse është lejuar më parë edhe nga MSH dhe nuk ka vërejtje nga Klinikat mund të ofroni me dim. 1.6 x 45 mm, nëse nuk oferton ndonjë nga OE tietër sipas L. Esenciale
3	Lot 11.3: A lejohet ofertimi me këtë specifikacion: 20 G 1.0 x 32 mm?	Nuk lejohet , referoju Listës Esenciale
4	Dimensionet ne Lot 11 I.V PLACEMENT UNIT duhet te jene te sakta sepse dimensionet e kërkuara, asnjë prodhues, as rajonal e as prodhues të tjerë, nuk i kanë në katalogët e tyre ?	Barnatorja Qendrore ka në stok këtë produkt me këto dimensione sipas Dosjes së Tenderit. Referoju Dosjes së Tenderit

|||||

AK duhet të respektojë specifikat nga LEB dhe nuk duhet të bëjë ndryshime, kur dihet që vetëm komiteti për LEB i caktuar nga ministri i shëndetësisë ka të drejtë për ndryshime në Listën Esenciale të Barnave.

Blerje duke tejkaluar vlerën e parashikuar

Vlera e parashikuar në dosje të tenderit caktohet paraprakisht dhe duhet të jetë e barabartë me çmimin përfundimtar që duhet të paguhet nga autoriteti kontraktues për të gjitha produktet¹⁴. Në SHSKUK vlera e parashikuar për produkte dhe pajisje medicinale caktohet nga Barnatorja Qëndrore me vendim të drejtorit të përgjithshëm të SHSKUK¹⁵-së.

Nga 12 dosjet e tenderëve, gjashtë tenderët e rekomanduar për dhënie nga SHSKUK, vlera e parashikuar (për 10 Lot-e), është tejkaluar. Për Dosjen e Tenderit me numër prokurimi: 00220-19-908-1-1-1, Furnizim me barna e cila kishte 39 Lot-e, Vendimi i Autoritetit Kontraktues së për tenderues të suksesshëm dhe të eliminuar ka anuluar aktivitetin e prokurimit për 18 Lot-e. Disa prej tyre janë anuluar për shkak se disa ofertues ishin administrativisht të papërgjegjshëm, disa nuk kishin dorëzuar deklaratën nën betim dhe për disa Lote nuk ishte pranuar asnjë ofertë¹⁶.

Në mesin Lot-eve të anuluar ishin edhe Lot 11 dhe Lot 28, pasi që ofertat për këto lote ishin mbi vlerën e parashikuar. Një muaj pas anulimit të këtyre aktiviteteve, Autoriteti Kontraktues rekomandon për kontratë një Operator Ekonomik oferta e të cilit kishte kaluar vlerën e parashikuar në të njëjtin aktivitet të prokurimit.

Lidhur me vendimin e tyre për pranim të ofertave që tejkalojnë vlerën e parashikuar, SHSKUK¹⁷ shpjegon se kjo është bërë pasi që nuk kanë pranuar ofertë me vlerë më të ulët dhe se kanë ardhë në përfundim se nuk është bërë hulumtimi i tregut në mënyrë të saktë.

Për Dosjen e Tenderit me numër prokurimi:
00220-19-908-1-1-1
 Furnizim me barna e cila kishte 39 Lot-e,
 Vendimi i Autoritetit Kontraktues së për
 tenderues të suksesshëm dhe të eliminuar ka
 anuluar aktivitetin e prokurimit për 18 Lot-e.

¹⁴ Ligji i Prokurimit Publik, Neni 16, Llogaritja e Vlerës së Parashikuar të Kontratës për Furnizim.

¹⁵ Takim me drejtoreshën e Barnatorës Qendrore në SHSKUK më 02 korrik 2019

¹⁶ Njoftimet mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues, të datës: 26 prill 2019 dhe 20 maj 2019 file:///C:/Users/Asus/OneDrive%20-%20Transparency%20International/Desktop/DOSJET%20SHSKUK/00220-19-908-1-1-1%20Furnizim%20me%20barna/B58%20NJOFTIM%20PER%20VENDIMIN%20E%20AK%20DHE%20LETRAT%20STANDARDE.PDF
 file:///C:/Users/Asus/OneDrive%20-%20Transparency%20International/Desktop/DOSJET%20SHSKUK/00220-19-908-1-1-1%20Furnizim%20me%20barna/B58%20NJOFTIM%20PER%20VENDIMIN%20E%20AK%2011%20dhe%2028%20dhe%20letra%20standarde.PDF

¹⁷ Takim me zyrtarw të prokurimit në SHSKUK, më 05.06.2019

|||||

Kjo dukuri është përsëritur edhe në tetë Lot-e tjera në pesë aktivitetete të prokurimit.

Tabela 2. Lot-et për të cilat është tejkaluar vlera e parashikuar

Dosja e Tenderit					
Furnizim me barna	Furnizim me material medicinal	Furnizim me material medicinal	Furnizim me barna	Furnizim me Natrium Chloride	Furnizim me material medicinal
LOT 11	LOT 17	LOT 3	LOT 13	LOT 1	LOT 2
Vlera e parashikuar 162,403.10€	Vlera e parashikuar 68,103.76€	Vlera e parashikuar 11,588.76€	Vlera e parashikuar 3,569.80€	Vlera e parashikuar 302,820.32€	Vlera e parashikuar 7,117.67€
Vlera e rekomanduar per dhënie 177,976.00€	Vlera e rekomanduar per dhënie 72,513.34€	Vlera e rekomanduar per dhënie 17,182.72€	Vlera e rekomanduar per dhënie 4,119.00€	Vlera e rekomanduar per dhënie 338,395.20€	Vlera e rekomanduar per dhënie 8,919.00€
Dallimi 9%	Dallimi 6%	Dallimi 48%	Dallimi 15%	Dallimi 11%	Dallimi 25%
LOT 28	LOT 5	LOT 2	LOT 6		
Vlera e parashikuar 11,020.50€	Vlera e parashikuar 52,539.03€	Vlera e parashikuar 79,348.64€	Vlera e parashikuar 34,920.80€		
Vlera e rekomanduar per dhënie 15,066.00€	Vlera e rekomanduar per dhënie 54,484.92€	Vlera e rekomanduar per dhënie 100,038.40€	Vlera e rekomanduar per dhënie 43,651.00€		
Dallimi 36%	Dallimi 3%	Dallimi 26%	Dallimi 25%		

Kjo dukuri e shfaqur shpesh tregon për probleme në fazën e planifikimit të tenderimit. Vlera e parashikuar e tenderit është shumë e rëndësishme të përcaktohet sa më saktë që është e mundur duke iu referuar një hulumtimi të tregut paraprak si dhe duke iu referuar çmimeve të barnave në rajon.

KONKLUSIONE

- Kërkesa për Çertifikatë të Autorizimit për Marketing, që është duke u aplikuar si kriter në dosjet e tenderit për furnizim me produkte medicinale e kufizon ofertën dhe mundëson rritjen e çmimeve nga ofertuesit.
- Kërkesa "mbi gjendjen ekonomike dhe financiare" nuk është e përfshirë në asnjë dosje të tenderit. Dëshmia për gjendjen ekonomike dhe financiare të një OE ka për qëllim të ofrojë siguri Autoritetit Kontraktues se OE ofertues ka stabilitet ekonomik dhe financiar.
- Kërkesa "mbi mundësitë teknike dhe profesionale" që është dëshmi për të treguar se OE i plotësojnë kualifikimet minimale të kërkuara në DT. Kërkesa e tillë është e përfshirë në dosje të tenderit për furnizimet me pajisje medicinale(material shpenzues) por jo edhe në DT tek furnizimet me produkte medicinale(barna dhe citostatik).
- SHSKUK, në katër dosje të tenderit u ka lejuar operatorëve ekonomik edhe ofertimin me produkte e pajisje medicinale jashtë specifikave në DT, të përcaktuara me Listën Esenciale të Barnave.
- Në gjithsej 10 Lot-e të dosjeve të tenderit, pas pranimit të ofertave nga operatorët ekonomik është tejkaluar vlera e parashikuar buxhetore për 98,913.20 euro ose (13%). Vlera e parashikuar e tregut e caktuar në mënyrë të gabuar rrezikon pjesëmarrjen nga ofertuesit serioz dhe mund të vonoj procesin e prokurimit duke rezultuar në vonesa në furnizim me produkte.

REKOMANDIME

- MSH-SHSKUK të lejojnë që në dosje të tenderit të vlejë edhe Autorizimi për tregtim i lëshuar nga shtetet për të cilat ekzistojnë procedurat për njohje e njëanëshme të autorizimit për marketing për produktet medicinale të aprovuara nga agjencionet rregullative në Gjermani dhe Britani të Madhe. Mirëpo, para nënshkrimit të kontratës për furnizim me produktin e caktuar, të kushtëzohet me paisjen e Autorizimit për Marketing nga Agjensioni për Produkte dhe Pajisje Medicinale.
- SHSKUK kriteret në dosje të tenderit të i vendos të standardizuara për aktivitete të prokurimit të ngjashme.
- SHSKUK në tenderët me vlera të mëdha të vendos edhe kriterin për gjendjen ekonomike dhe financiare në mënyrë që të dëshmohet se ofertuesi posedon stabilitet të mjaftueshëm financiar për realizim të kontratës, mirëpo pa rrezikuar konkurrencën e drejtë në treg dhe diskriminuar operatorët e ri në treg.
- SHSKUK të respektojë specifikat e vendosura në dosje të tenderit dhe jo të bëjë ndryshim të specifikave të produkteve dhe pajisjeve medicinale nga Lista Esenciale e Barnave pas publikimit të dosjes së tenderit.
- SHSKUK për çdo prokurim të bëjë hulumtim të tregut duke iu referuar çmimeve të rajonit, kontratave të ngjashme, çmimit të tregut në Kosovë, në mënyrë që vlera e parashikuar të jetë njëjtë me çmimin që do të nënshkruhet kontrata.

KDI është Organizatë Joqeveritare (OJQ) e angazhuar të mbështesë zhvillimin e demokracisë përmes përfshirjes së qytetarëve në bërjen e politikave publike dhe fuqizimin e sektorit të shoqërisë civile me synimin për të ndikuar në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies nga ana e institucioneve publike.
Për më shumë informata rreth KDI ju lutem vizitoni **www.kdi-kosova.org**

Me përkrahjen financiare të:



British Embassy
Pristina